



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:098280

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05421987

**P.nr.78/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale, të akuzuarve D. K. dhe R.K., për shkak veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave në bashkëkryerje nga neni 406 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë PP/II. nr.454/22 të dt. 12.05.2022, me propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës për shqyrtimin gjyqësor me dt.07.03.2024, merr këtë:**

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-Gjakovë Gjakovë PP/II. nr.454/22 të dt. 12.05.2022, ndërsa Gjykata, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**TË AKUZUARIT:**

**1. D. M.K.**, lindur me dt...., në fshatin P. komuna e Malishevës, me nr personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. R. M. K.**, lindur me dt.... në fshatin P. komuna e Malishevës, me nr personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**J A N Ë F A J T O R Ë**

Për shkak se me datë 21.02.2022 në fshatin C. Komuna e Malishevës, saktësisht në njësinë kadastrale me numër P-..., të pandehurit me dashje dhe në bashkëveprim me njëri tjetrin i kanë hequr shenjat zyrtare të cilat me datë 18.02.2022 ishin vendosur nga Inspektorët Komunal pranë Komunës së M. të cilët i kishin ndërprerë punimet dhe e kishin rrethuar vendin me shirita zyrtar, në atë mënyrë që të pandehurit D. dhe R.K. në cilësinë e punëmarrësve/punëkryesve i kanë hequr shiritat / shenjat zyrtare të cilat ishin vendosur dhe kanë vazhduar punimet edhe pse kanë qenë në dijeni se nuk kanë të drejtë të punojnë.

- me këto veprime kanë kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave në bashkëkryerje nga neni 406 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 406 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 360, 364, 453, 462 dhe 495, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtëve u`a shqipton:

## DËNIMIN ME GJOBË

1. Të akuzuarin **D.** me dënimin me gjobë në shumën prej **300 €** (treqind euro), të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar në të holla nuk e paguan në afatin e cekur. i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgim në kohëzgjatjen prej 15 ditësh, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi nga 20 €.

2. Të akuzuarin **R.K.**, me dënimin me gjobë në shumën prej **300 €** (treqind euro), të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar në të holla nuk e paguan në afatin e cekur. i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgim në kohëzgjatjen prej 15 ditësh, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi nga 20 €.

Obligohen të dënuarit që në emër të paushallit gjyqësor, Gjykatës t'ia kompenson shumën secili prej 20 € (njëzet) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit shumë secili prej 20 euro, ndërsa shpenzime të procedurës nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

PTH-Gjakovë me aktakuzën PP/II. nr. 454/22 të dt.12.05.2022, me propozim për dhënien e urdhrin ndëshkimor, i ka akuzuar D. K. dhe r. K., për shkak të veprës penale heqja ao dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave në bashkëkryerje nga neni 406 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që ta pranon kërkesën për urdhër ndëshkimor, më të cilin të akuzuarit t'i dënon me dënimin me gjobë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes penale, vërtetoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 dhe neni 495 të KPPK së , e aprovoi propozimin e PTH-së për dhënien e urdhrin ndëshkimor, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është vlerësim i gjykatës se provat që i janë të bashkangjitura propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor, e të cilat gjinden në shkresat lëndës janë: Raporti i policit S. M., datë 21.02.2022, kërkesa e Drejtorisë së Inspektoratit Nr...., dt.18.02.2022, certifikata mbi të drejtat e pronësisë Nr...., deklaratat e të pandehurve të dhëna në polici me dt.21.02.2022, fotografite e vendit të ngjarjes dhe shkresat tjera të lëndës, e që janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për ta shpallur fajtor të akuzuarin.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështet në nenin 449 par.1 dhe 2 KPPK-së, ndërsa vendimin në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr

konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimit e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.78/22 me dt.07.03.2024**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të te njëjtit, kësaj Gjykate, në të kundërtën nëse i akuzuari nuk e ushtron kundërshtimin, aktgjykim do ta marr formën e prerë.